Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Gjemajli Bellanica;	01.06.2022	10.06.2022	*168/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.05.2022 OE "**Lindi Markings**" Sh.p.k & "**BENI-COM**" Sh.p.k Vitomiricë**,** ka parashtruar ankesë me nr. 168/22 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit ku është rekomanduar për kontratë OE N.SH "**Liriu**" Suharekë, lidhur me aktivitetit e prokurimit me titull: "**Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal i Rrugëve**", me nr. të prokurimit: **623-22-1304-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK – Rahovec.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar kontratë publike kornizë me një operator ekonomik, procedurë të hapur, Punë, vlera e parashikuar e kontratës: 150.000.00 €

Data e njoftimit për kontratë.....02.03.2022.
Hapja e ofertave.....23.03.2022.
Data e njoftimit të vendimit të AK-së.....11.05.2022.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....16.05.2022.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....18.05.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE “Lindi Markings” Sh.p.k & “BENI-COM” Sh.p.k Vitomiricë

Dispozitat e shkelura

Neni 1 - Qëllimi
Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Të nderuar ne me dt. 11.05.2022 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së ku e ka rekomanduar për kontratë **OE N.SH “Liriu”**, ndërsa neve na ka shpallur si tenderues të eliminuar me arsyetimin se:

Në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat të natyrës së ngjashme, (furnizim me shenja, sinjalistike dhe të ngjashme me natyrën e projektit)

Referenca/t ose Pranimit teknik për punë të kryera në lëmin e punëve të ngjashme (furnizim me shenja, sinjalistike dhe të ngjashme me natyrën e projektit), të dorëzuar nga ana juaj, janë në vlerë prej: 223,238.62 €uro në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Kurse sipas FDT–së është kërkuar: Kërkesa minimale e kontratave te realizuara e cila duhet te përmbushet nga O.E. i cili aplikon është në vlerë min. 225,000.00 €uro

Në ofertën e juaj të dorëzuar Mungojnë Kodet e produkteve në Katalog;
Po ashtu mungojnë dhe produktet e kërkuara në ofertë dhe Katalogu është i panënshkruar dhe i pavulosur nga personi i autorizuar i Kompanisë, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform LPP-së

Plani për menaxhim te trafikut nuk ka të bëjë me rastin specifik – qyteti i Rahovecit, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform LPP-së

Ju sqarojmë se arsyet e AK-së për eliminimin tonë janë të paqëndrueshme për faktet si më poshtë:

Sa i përket arsyes të parë për eliminimin tonë, ku e ka cekur se kinse nuk kemi ofruar kontrata në vlerën e kërkuar prej 225,000.00 €, ju sqarojmë se ky arsyetim i AK-së është i pabazuar dhe nuk qëndron për faktin se ne jo vetëm që e plotësojmë vlerën minimale të kontratave të kërkuara, mirëpo edhe e tejkalojmë atë.
Nëse analizohen kontratat e prezantuara nga ana jonë shihet qartë se arsyeja është e paqëndrueshme. AK-ja siç duket i ka marr parasysh vetëm kontratat e vitit 2020 dhe 2021, duke mos i analizuar në tërësi të gjitha kontratat e prezantuara nga ana jonë, mirëpo i ka shikuar vetëm datat e nënshkrimit të kontratës.

Ne po e përmendim vetëm njërën nga kontratat e prezantuara nga ana jonë me anë të së cilës e tejkalojmë vlerën minimale të kërkuar nga ana e AK-së. Nëse analizohet kontrata me KK Obiliq, shihet qartë se njëjta **është e lidhur me dt.06.06.2018 dhe e njëjta mbaron pas një viti pra me 06.06.2019,** në të njëjtën kontratë ne kemi përfunduar edhe punë shtesë vlera e të cilave është 4,830.40 €, fakt ky që tregon qartë se arsyeja e lartcekur për eliminimin tonë është e paqëndrueshme dhe njëkohësisht e pa mbështetur në dispozita ligjore.

AK-ja është dashur ti analizoj në tërësi kontratat e prezantuara nga ana jonë dhe pastaj të bëjë vlerësimin e tyre konform dispozitave ligjore, sepse nuk mund dhe nuk duhet të merret parasysh vetëm data e nënshkrimit të kontratës, mirëpo data e përfundimit të saj, andaj konform këtyre fakteve kuptohet qartë se ne si OE e përmbushim kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë në lidhje me kontratat e përfunduara në tri vitet e fundit.

Në arsye tjetër të AK-së për eliminimin tonë e ka cekur se:

Në ofertën e juaj të dorëzuar Mungojnë Kodet e produkteve në Katalog;
Po ashtu mungojnë dhe produktet e kërkuara në ofertë dhe Katalogu është i panënshkruar dhe i pavulosur nga personi i autorizuar i Kompanisë, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform LPP-së

Arsyeja e lartcekur për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme dhe njëkohësisht e njëjta arsye bie në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ MI Nr.09/2017 për Sinjalizim dhe Rregullat e Trafikut Rrugor, e i cili UA i ka përcaktuar qartë kodet dhe shifrat për produktet e sinjalizimit, andaj ne si OE dhe asnjë OE tjetër nuk ka të drejtë të vendos kode dhe shifra sipas dëshirës së tyre në katalog, pasi që siç e cekëm kodet dhe shifrat e produkteve janë të rregulluara me udhëzuesin e lartcekur i cili është i nënshkruar nga Ministri i Infrastrukturës z. Lutfi Zharku me dt.20.06.2017. **(Bashkangjitur keni UA MI Nr.09/2017).**

Ndërsa sa i përket arsyetimit të AK-së se ne e kemi prezantuar katalogun e pa nënshkruar dhe të pa vulosur, ju sqarojmë se ky është vetëm një lëshim teknik nga ana jonë ku gjatë ofertimit e kemi bashkangjitur katalogun e pa nënshkruar dhe të pa vulosur në vend të atij të vulosur dhe të nënshkruar. Pra ne e posedojmë katalogun e nënshkruar dhe të vulosur, mirëpo që për shkak të një lëshimi teknik i njëjti nuk është bashkangjitur ne ofertë.

Mirëpo në lidhje me mos nënshkrimin dhe vulosjen e katalogut dhe nëse AK-ja ka pasur ndonjë dilemë tjetër në lidhje me katalogun e prezantuar nga ana jonë, atëherë shumë lehtë ka mundur të kërkojë sqarime shtesë konform dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së dhe ne do të kishim qartësuar të gjitha dilemat e AK-së, mirëpo një veprim të tillë nuk e ka bërë, dhe se janë munduar që me çdo kusht të na eliminojn neve si OE i përgjegjshëm dhe njëkohësisht më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Ndërsa sa i përket arsyes së fundit për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit, ku AK-ja e ka cekur se kinse *"Plani i menaxhimit të trafikut nuk ka të bëjë me rastin specifik –qyteti i Rahovecit"*, ju sqarojmë se edhe ky arsyetim për eliminimin tonë është vetëm një pretekst për të na eliminuar neve si OE i përgjegjshëm dhe më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Ne në ofertë e kemi prezantuar planin e menaxhimit të trafikut për aktivitetin e prokurimit *"SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL I RRUGËVE"* në KK Rahovec, mirëpo për ne është e çuditshme se si ka mundësi që AK-ja të na eliminoj se kinse ky plan i prezantuar nga ne nuk ka të bëj me qytetin e Rahovecit, përderisa ne kemi ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit i iniciuar nga vet KK Rahovec, ku edhe tek titulli i planit të menaxhimit të trafikut shkruan se Sinjalizimi do të bëhet në komunën e Rahovecit.
Ky arsyetim i juaji edhe një herë po e dëshmon qartë diskriminimin që po na bëni ju si AK neve si OE i përgjegjshëm dhe më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Andaj duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura shihet qartë se ne si OE jemi diskriminuar në këtë aktivitet të prokurimit, ku edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njëkohësisht jemi OE më i lirë, po eliminohemi me arsyetime krejtësisht të pa bazuara dhe të paqëndrueshme, andaj kërkojmë nga ju si OSHP ti analizoni në tërësi dokumentet e prezantuara nga ana jonë dhe pasi që ti analizoni të nxjerrni një vendim konkret në lidhje me ofertën tonë.

Gjithashtu AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE i cili nuk i përmbush të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se i njëjti nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale në lidhje me stafin e kërkuar. Tek dosja e tenderit është kërkuar që OE ofertues ti posedojnë 8 punëtorë gjithsej duke përfshirë edhe stafin profesional, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë i ka prezantuar gjithsej 7 punëtorë në listën e stafit.

I njëjti tek lista e stafit është munduar të manipulojë me listën e stafit ku tek numrat e listës mungon numri katër, ku është shumë i çuditshëm fakti se si AK-ja nuk e ka vërejtur me apo pa qëllim një fakt të tillë. Nga fotoja e mëposhtme vërehet qartë fakti se si OE i rekomanduar për kontratë është munduar të manipulojë me listën e stafit:

Lista e Stafit

	Nr	Emri	Mbiemri	Data lindjes	Eksperienca	Profesioni	
1	1	KORAB	ELSHANI	18.02.1987	10	Inxhinier i komunikacionit	
2	2	SELMAN	KOLGECI	25.11.1988	12	Inxhinier i komunikacionit	
3	3	FETIE	KUÇI - KRASNIQI	06.07.1989	3	Inxhinier i komunikacionit	
4	5	LULZIM	KOLGECI	22.04.1997	5	Makinist per shenjezime horizontale	
5	6	GAZMEND	KOLGECI	10.04.1993	5	Makinist/ Punëtorë	
6	7	ELEZ	KADRIAU	23.09.2002	3	Punëtorë	
7	8	EGZON	SHALA	16.11.1992	3	Punëtorë	

AK-ja siç duket nuk i ka analizuar në tërësi dokumentet e prezantuara nga OE i rekomanduar për kontratë, mirëpo qëllimi i saj i vetëm ka qenë eliminimi ynë nga ky aktivitet i prokurimit, ndërsa nga veprimet e AK-së shihet qartë se në këtë aktivitet të prokurimit e ka favorizuar haptas OE të rekomanduar për kontratë.

Po ashtu OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit përkatësisht tek kapaciteti teknik dhe profesional ku kërkesë ka qenë *"Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Makinerisë ose Master – Drejtimi Komunikacion Rrugor, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;*

- *CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);*
- *Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt;*
- *Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;*
- *Një deklarate me shkrim për caktimin e Menaxherit te Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 2.1 & 2.2".*

OE i rekomanduar për kontratë në lidhje me kërkesën e lartcekur ka prezantuar në ofertë znj. Fetije Kuçi-Krasniqi si inxhiniere të komunikacionit përkatësisht menaxhere të projektit, e për të cilën ka bashkangjitur një referencë të lëshuar po nga OE i rekomanduar për kontratë, ku shkruan se e njëjta ka kryer punë që nga periudha Mars-2018 deri në Mars 2020. Në kontratën e lidhur mes inxhinieres dhe OE të rekomanduar për kontratë figuron se e njëjta kontratë është lidhur me dt.08.03.2018, ndërsa e punësuara do të ketë pozitën në kompani me titull: Inxhiniere e Komunikacionit. Nëse analizohet diploma e inxhinieres, shihet qartë se e njëjta ka diplomuar me dt.12.04.2018, datë kjo që tregon mos përputhjes në mes të datës së kontratës dhe datës së diplomimit, pasi që kontrata është lidhur për pozitën inxhiniere të komunikacionit ende pa i përfunduar e njëjta studimet. Pra ne dyshojmë se kontrata është fiktive sepse nuk mund dhe nuk duhet të lidhet një kontratë për një pozitë me titull Inxhiniere, përderisa e njëjta nuk e posedon titullin inxhiniere.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku kërkesë ka qenë *"Katalogu i produkteve të kompanisë me kod dhe shifër për secilin produkt"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Një kopje e katalogut i nënshkruar dhe vulosur nga personi i autorizuar i Kompanisë"*.
OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se i njëjti ka

prezantuar kode në katalog të cilat nuk janë në përputhje me Udhëzimin Administrativ MI Nr.09/2017 për Sinjalizim dhe Rregullat e Trafikut Rrugor. Në udhëzimin e lartcekur ashtu siç e kemi cekur edhe më lartë janë të përcaktuara qartë kodet dhe shifrat për produktet e sinjalizimit dhe asnjë OE nuk mund dhe nuk duhet të vendos kode tjera, pasi që në këtë rast udhëzimi i lartcekur është ligj për OE dhe i njëjti duhet të respektohet, mirëpo që në këtë rast AK-ja nuk e ka respektuar pasi që ka rekomanduar për kontratë një OE i cili ka prezantuar në ofertën e tij kode të cilat nuk janë në përputhje me udhëzimin e lartcekur.

Andaj duke u bazuar në sqarimet e lartcekura shihet qartë se AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-sw, mirëpo që një veprim të tillë nuk e ka bërë duke e favorizuar haptas OE të rekomanduar për kontratë dhe duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm dhe njëkohësisht me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Me dt. 18.05.2022 ne kemi pranuar vendimin e AK-së në lidhje me kërkesën tonë për rishqyrtim ku e njëjta e ka refuzuar me arsyetimin se e njëjta është e pabazuar.

Në lidhje me arsyetimin e parë të AK-së ku e njëjta e ka cekur se
Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që ju keni ofruar listën e punëve të kryera në të cilën keni theksuar se posedoni gjithsej tetë (8) kontrata dhe nga to janë vetëm tri (3) kontrata ne periudhën e shkuar tre (3) vjeçare para njoftimit për kontratë. Vlera e këtyre tri (3) kontratave është: ***223,238.62 €*** *(dyqind e njëzet e tremijë e dyqind e tridhjetë e tetë euro e gjashtëdhjet e dy cent) pra me listën e paraqitur ju nuk keni arritur të dëshmoni që e plotësoni kriterin :* ***Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në lidhje me listën e projekteve në tri vitet e fundit.***

Ju sqarojmë se arsyetimi i lartcekur i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është tërësisht i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm, për faktin se AK-ja i është referuar gabimisht dispozitave të nenit 39 të RRUOPP-së, pasi që e ka marr parasysh vetëm datat e listës së kontratave, mirëpo nuk i ka analizuar në tërësi të gjitha kontratat dhe nuk i ka marr parasysh fare punët shtesë për të cilat e kemi sqaruar edhe në kërkesë për rishqyrtim se të njëjtat duhet të merren parasysh. Pra AK-ja me arsyetimin e lartcekur edhe një herë po e tregon haptas diskriminimin që po na bëhet neve si OE i përgjegjshëm dhe njëkohësisht më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit, me arsyen e vetme favorizimin e OE të rekomanduar për kontratë. AK-ja edhe një herë sikurse në njoftimin mbi vendimin e saj, po i përsërit arsyet e njëjta edhe tani në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, andaj edhe arsyetimi i lartcekur është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm.

Në arsyetimin tjetër për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim AK-ja e ka cekur se:
Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që ju keni dorëzuar një album me fotografi gjatë kryerjes së punëve nëpër terren të pa nënshkruar dhe të pa vulosur dhe po e quani katalog, ndërsa ne kemi kerkuar si vijon:

Kërkesa 5 a Katalogu i produkteve të kompanisë me kod dhe shifër për secilin produkt.	Dëshmia 5 a Një kopjo e katalogut i nënshkruar dhe vulosur nga personi i autorizuar i Kompanisë

Ndërsa sa i përket çështjes se UA09/2017 i Ministrisë së Infrastrukturës, ne nuk kemi kerkuar të bashkëngjitet udhëzimi por katalogu i kompanisë i nënshkruar dhe i vulosur për arsye se gjate porosive te ndryshme Menaxheri i kontratës porosinë e bene ne baze te kodeve-numrave apo shifrave tjera ne katalogun e OE qe do te lidhe kontratë me AK: Komuna e Rahovecit.

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Edhe ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar në dispozita ligjore për faktin se AK-ja nuk ka shprehur interes fare të kërkoj sqarime shtesë konform dispozitave të nenit 59.2 të LPP-së ku është përcaktuar qartë se *"2.Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve"*. Pra edhe përkundër faktit se në dispozitën e lartcekur është përcaktuar qartë se kur duhet të kërkohen sqarime shtesë dhe AK-ja nuk ka kërkuar sqarime nga ana jonë në lidhje me katalogun, me këtë veprim AK-ja edhe një herë po e tregon qartë dhe haptas diskriminimin që po i bën kompanisë tonë si OE të përgjegjshëm dhe më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit. Nëse e njëjta do të kërkonte sqarime shtesë atëherë shumë lehtë do të vërtetohet fakti se pretendimi ynë ankimor është i qëndrueshëm dhe ne jemi OE të përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Ndërsa sa i përket çështje se udhëzimit administrativ të lartcekur, ku AK-ja e ka cekur se e kanë kërkuar katalogun me kode dhe shifra sepse në bazë të tyre bëhet porosia, ju sqarojmë se arsyetimi i AK-së është vetëm një pretekst për të na eliminuar neve nga ky aktivitet i prokurimit, për faktin se udhëzimi i lartcekur i ka përcaktuar kodet dhe shifrat për të gjitha produktet, andaj edhe porositë bëhen në bazë të udhëzimit. Udhëzimi i lartcekur vlen për të gjithë OE dhe të gjitha AK që marrin pjesë dhe iniciojnë procedura me produkte të sinjalizimit dhe të njëjtat duhet të i përmbahen kodeve dhe shifrave të cilat janë të përcaktuara në udhëzimin UA 09/2017, andaj arsyetimi i lartcekur i AK-së është i pa bazuar dhe nuk qëndron.

AK-ja në arsyetimin tjetër në lidhje me pretendimin tonë ankimor sa i përket planit të menaxhimit të trafikut, e ka cekur se:

Sa i përket kësaj pike, nga kërkesa 5c është kerkuar dëshmia 5c ku ne mënyre specifike kemi kerkuar qe Të prezantohet plani për menaxhim te trafikut i nënshkruar nga Inxhinieri ose Bachelor i Komunikacionit dhe përpilohet për rastin specifik-qyteti i Rahovecit. Pra ju e keni dorëzuar një plan te menaxhimit te trafikut por që nuk ka të bëjë me rastin specific Komuna e Rahovecit, dhe si I tille nuk e plotëson ketë kërkesë te dosies se tenderit.

AK-ja edhe në këtë arsyetim nuk ka dhënë një përgjigjje konkrete se përse ka dhënë këtë arsye të eliminimit, mirëpo përsëri ka vazhduar me avazin e njëjtë duke e përsëritur arsyen e njëjtë sikurse në në njoftimin mbi vendimin e saj. Pra e njëjta pasi që na ka eliminuar me një arsye e cila është e paqëndrueshme dhe nuk mund ta vërtetojë një gjë të tillë tani vetëm po e përsërit arsyen e njëjtë pa dhënë ndonjë dëshmi dhe fakt konkret që e tregon të kundërtën e pretendimit tonë ankimor dhe që e vërteton arsyen e eliminimit të saj.

Ndërsa sa i përket pretendimit tonë ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë në lidhje me stafin e të njëjtit, AK-ja duke e favorizuar haptas ka dhënë këtë arsyetim:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka prezantuar listën e punëtorëve/stafit teknik, në të cilat janë te prezantuar stafi i përhershëm, stafi menaxherial dhe të punëtorëve prej: **Shtatë (7) punëtor të nënshkruar dhe te vulosur nga Operatori Ekonomik**, ne pajtim me Kërkesën 1 / Dëshminë 1, të Kapacitetit teknik dhe profesional sipas FDT-së

Për këtë çështje ka vendim edhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, si për shembull vendimi nr. 710/19.

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Arsyetimi i lartcekur i AK-së është tërësisht i pa bazuar dhe njëkohësisht favorizim i hapur ndaj OE të rekomanduar për kontratë, pasi që ne e kemi prezantuar me fakte të qarta se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse i ka prezantuar vetëm 7 punëtorë fakt ky që e ka pranuar edhe vetë AK-ja, mirëpo e njëjta është munduar të manipuloj me kërkesën e dosjes së tenderit sepse në njërën nga kërkesat e dosjes së tenderit janë kërkuar 6 punëtorë dhe tek kërkesa tjetër tek stafi profesional është kërkuar një menaxher i projektit -Inxhinier i Diplomuar Makinerisë ose Master – Drejtimi Komunikacion Rrugor, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit, një Udhëheqësi i Punishtes – Master ose Bachellor i Komunikacionit, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit dhe një Ekspert i Licencuar për siguri dhe shëndet ne pune ne profilin e Komunikacionit, i Licencuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Pra janë kërkuar 6 punëtorë dhe 3 të tjerë staf profesional në total 9, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë i ka prezantuar vetëm 7 punëtorë në total edhe pse i njëjti është munduar të manipuloj me numrat rendor të listës së stafit. AK-ja edhe pse të gjitha këtyre fakteve të cilat tregojnë qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit, përsëri po e favorizon OE të rekomanduar për kontratë duke e cekur se kinse ekziston një vendim i panelit shqyrtues në lidhje me këtë çështje. Mirëpo në këtë rast asnjë vendim i panelit shqyrtues nuk mund ta dëshmoj të kundërtën e pretendimit tonë ankimore, për faktin se kërkesa është shumë e qartë dhe OE i rekomanduar për kontratë nuk i është përmbajtur kërkesave të dosjes së tenderit, pasi që nuk i ka plotësuar ato dhe asnjë vendim i OSHP-së nuk e cek se OE mund të rekomandohet për kontratë edhe nëse nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit. Po ashtu në vendimin 710/19 të cilin e ka cekur AK-ja, askund nuk thuhet se një OE i mungon stafi i kërkuar, mirëpo në këtë vendim është kontestuar fakti se OE nuk i ka ofruar dëshmitë për stafin profesional. Andaj duke u bazuar në sqarimin e lartcekur kuptohet qartë se arsyetimi AK-së është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar dhe i pa mbështetur në dispozita ligjore.

Po ashtu AK-ja në lidhje me pretendimin tonë tjetër ankimor kundrejt OE të rekomanduar për kontratë ku e kemi cekur se i njëjti është i papërgjegjshëm sepse nuk ka ofruar katalogun me kode dhe shifra sipas udhëzimit administrativ UA 09/2017, AK-ja përsëri ka dhënë arsyetimin e njëjtë sikurse tek pretendimi ynë i tretë ankimor ku e ka cekur se:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj është i pabazuar, për pikë që ju pretendoni që OE i rekomanduar për kontrate ka dorëzuar katalog me kode të cilat nuk janë sipas udhëzimit administrative ju sqarojmë se:

- Ne nuk kemi kerkuar qe katalogu i Operatoreve Ekonomik te jete i njëjte me udhëzimin e Ministrisë se Infrastrukturës sepse siç e cekem me larte duhet te prezantohet katalogu i kompanisë i nënshkruar dhe i vulosur për arsye se gjate porosive te ndryshme Menaxheri i kontratës porosinë e bene ne baze te kodeve-numrave apo shifrave tjera ne katalogun e OE qe do te lidhe kontratë me AK: Komuna e Rahovecit.

Në lidhje me këtë arsyetim të AK-së ju sqarojmë se i njëjti arsyetim është i paqëndrueshëm ashtu siç e kemi theksuar edhe më lartë. AK-ja edhe një herë po e shfaq hapur favorizimin që po i bën OE të rekomanduar për kontratë, pasi që siç edhe e cekëm udhëzimi i lartcekur i ka përcaktuar shifrat dhe kodet për produktet e sinjalizimit dhe OE duhet të ofertojnë konform atij udhëzimi, andaj edhe porositë duhet të bëhen konform udhëzimit dhe asnjë OE nuk mund dhe nuk duhet të veproj në kundërshtim me udhëzimin e lartcekur.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm, pasi që i njëjti nuk është i mbështetur në dispozita ligjore, mirëpo arsyet e refuzimit janë vetëm pretekste për të na eliminuar neve si OE i përgjegjshëm dhe më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit dhe gjithashtu ky vendim sikurse njoftimi mbi vendimin e AK-së, janë favorizim i hapur ndaj OE të rekomanduar për kontratë dhe si i tillë i njëjti vendim nuk duhet të merret parasysh, mirëpo lënda duhet të kthehet në rivlerësim.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne jemi OE më i lirë dhe gjithashtu i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar edhe nenin 6 të LPP-së, sepse janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Po ashtu AK-ja nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa OE **"Lindi Markings" SH.P.K. & "BENI –COM" SH.P.K.**
si e bazuar,
ANULOHET, njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës për dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

Kërkesa 1 Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin professional, komercial dhe ose regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit

Kërkesa 2 Regjistrimi i TVSH – së

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve te fundit, në vlerë jo më pak se: 300,000.00 €uro

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesa 1 Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 6 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca (vite) dhe pozicioni në kompani.

Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listën te paktën këtë staf profesional

2.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Makinerisë ose Master – Drejtimi Komunikacion Rrugor, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit.

2.2. Udhëheqësi i Punishtes – Master ose Bachellor i Komunikacionit, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit.

Kërkesa 3 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme (furnizim me shenja, sinjalistike dhe të ngjashme me natyrën e projektit), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 225,000.00 €uro

Kërkesa 4 Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit

- Makine për sinjalizim horizontal, Dy (2) cope

- Makine për sinjalizim horizontal ngjyre e plastifikuar, Një (1) cope

- Printer apo katër për punimin e foljes, Një (1) cope

Kërkesa 5

a Katalogu i produkteve të kompanisë me kod dhe shifër për secilin produkt.

b Dëshmi apo kontrate për prodhimin apo furnizimin me gypa te zinguara, ngjyre për aplikim ne rruge.

c Një plan për menaxhimin te trafikut.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

Dëshmia 1 Certifikatën e regjistrimit te Biznesit – se bashku me informatat për biznesin, te lëshuar nga Autoritetet e Regjistrimit te Biznesit – Kopje

Dëshmia 2 Certifikatën e TVSH – Kopje

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

Dëshmia 1 Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK

Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Dëshmia 1.Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, min. 6 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca (vite) dhe pozicioni në kompani dhe nënshkrimi i punëtorëve ne atë liste – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik.

Dëshmia 2

• Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar;

• CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);

• Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt;

• Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;

• Një deklarate me shkrim për caktimin e Menaxherit te Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 2.1 & 2.2

Dëshmia 3 Lista e projekteve te kryera në lëmin e punëve të ngjashme (furnizim me shenja, sinjalistike dhe të ngjashme me natyrën e projektit), të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Titujt e projekteve, shumën e kontratës, numrin e Prokurimit, data e kontraktimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referenca t ose Pranimit teknik.

Dëshmia 4 Lista origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik e pajisjeve – mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e shërbimeve te kërkuara, Listës duhet ti bashkëngjiten, njëra nga këto dëshmi

kopje të librezës së qarkullimit me validitet, DUD doganorë apo faturë për blerjen ose nëse ka marrëveshje ose kontrate e marrjes me qira të pajisjeve për projektin në fjale (marrëveshja ose kontratë duhet të jetë e noterizuar).
Dëshmia 5

a Një kopje e katalogut i nënshkruar dhe vulosur nga personi i autorizuar i Kompanisë

b Dëshmi apo kontrate për prodhimin apo furnizimin me gypa te zinguara, ngjyre për aplikim ne rruge.

c Të prezantohet plani për menaxhim te trafikut i nënshkruar nga Inxhinieri ose Bachelor i Komunikacionit dhe përpilohet për rastin specifik-qyteti i Rahovecit.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
KOMUNA E RAHOVECIT **shpërblen** me kontratë:

N.SH. "Liriu", Brig. 123, 23000, SUHAREKË	**99.60 €uro** – Çmimi për njësi me poentim

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "Lindi Markings" Sh.p.k & "BENI-COM" Sh.p.k Vitomiricë

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1
OE ankues pretendon se arsyetimi i AK-së ku e ka cekur se kinse nuk kemi ofruar kontrata në vlerën e kërkuar prej 225.000.00 Euro, ky arsyetim është i pa bazuar dhe nuk qëndron për faktin se ne jo vetëm që e plotësojmë vlerën minimale të kontratave të kërkuar, mirëpo edhe e tejkalojmë atë. AK-ja siç duket
I ka marr parasysh vetëm kontratat e vitit 2020 dhe 2021, duke mos i analizuar në tersi të gjitha kontratat e

prezantuara nga ana jonë, mirëpo i ka shikuar vetëm datat e nënshkrimit të kontratës.

Ne po përmendim vetëm njërën nga kontratat e prezantuar nga ana jonë me anë të së cilës e tejkalojmë vlerën minimale të kërkuar nga ana e AK-së. Nëse analizohet kontrata me KK-Obiliq, shihet qartë se e njëjta është e lidhur me dt. 06.06.2018 dhe e njëjta mbaron pas një vitit pra me 06.06.2019, në të njëjtën kontratë ne kemi përfunduar edhe punë shtesë vlera e të cilave është 4 830.10 Euro, fakt ky që tregon qartë se arsyeja e lartcekur për eliminimin tonë është e pa qëndrueshme dhe njëkohësisht e pa mbështetur në dispozita ligjore.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme (furnizim me shenja, sinjalistike dhe të ngjashme me natyrën e projektit), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 225,000.00 €uro*"

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar:

"*Lista e projekteve te kryera në lëmin e punëve të ngjashme (furnizim me shenja, sinjalistike dhe të ngjashme me natyrën e projektit), të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Titujt e projekteve, shumën e kontratës, numrin e Prokurimit, data e kontraktimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referenca ose Pranimit teknik*".

Për plotësimin e kësaj kërkese të DT-së, nga ana e OE ankues është prezantuar një listë e kontratave e nënshkruar dhe vulosur, në të cilën janë listuar gjithsej tetë (8) kontrata, ku jo të gjitha janë të përfunduara në periudhën tre (3) vjeçare nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Si dhe janë prezantuar kontrata dhe referencë si dëshmi. Kontrata e listuar me numër rendor katër (4) e cila është e lidhur në mes OE ankues dhe AK - Komuna e Obiliqit, është lëshuar një referencë me dt.28.08.2018. Kjo kontratë ka hy në fuqi me dt. 06.06.2018 dhe data e përfundimit në kontratë është 07.06.2019. Gjithashtu me dt. 06.07.2018 AK-ja i ka dërguar një kërkesë OE ankues për ekzekutimin e projektit (punë shtesë).

Eksperti shqyrtues thekson se, meqë për punët shtesë nuk është prezantuar ndonjë referencë mirëpo vetëm është ofruar paramasa dhe parallogaria, gjatë rivlerësimit AK-ja konform nenit 72 të LPP-së të kërkoj sqarime dhe të verifikohet se në çfarë periudhe kohore janë përfunduar këto punë shtesë, në mënyrë që të kuptohet se këto punë shtesë a janë realizuar në periudhën tre vjeçare nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

OE ankues thekson se arsyeja e dytë e eliminimit tonë se *në ofertë mungojnë Kodet e produkteve në katalog*, ky arsyetim është i pa bazuar dhe njëkohësisht e njëjta arsye bie në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ MI Nr.09.2017 për sinjalizim dhe rregullat e trafikut rrugor, e i cili UA i ka përcaktuar qartë kodet dhe shifrat për produktet e sinjalizimit, andaj ne si OE dhe asnjë OE tjetër nuk ka të drejtë të vendos kode dhe shifra sipas dëshirës së tyre në katalog, pasi siç cekëm më lartë kodet dhe shifrat e produkteve janë të rregulluara me udhëzuesin e lartcekur i cili është i nënshkruar nga ministri i Infrastrukturës z. Lutfi Zharku me dt. 20.06.2017. Ndërsa sa i përket arsyes tjetër se ne kemi prezantuar katalogun e pa nënshkruar dhe të pa vulosur, ju sqarojmë se ky është vetëm një lëshim teknik nga ana jonë ku gjatë ofertimit e kemi bashkangjitur katalogun e pa nënshkruar dhe të pa vulosur në vend të atij të vulosur dhe të nënshkruar.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*Katalogu i produkteve të kompanisë me kod dhe shifër për secilin produkt*".
Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Një kopje e katalogut i nënshkruar dhe vulosur nga personi i autorizuar i Kompanisë*".

Lidhur me këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues në ofertën e tij ka prezantuar një katalog i cili nuk mban kod dhe shifër në produkte, gjithashtu katalogu nuk është i vulosur dhe as nënshkruar nga OE ankues. Mirëpo ekziston edhe një Udhëzim Administrativ i Ministris së Infrastrukturës me nr.09/2017 i cili është burim thelbësor për natyrën e aktivitetit të prokurimit dhe në këtë udhëzim janë të përcaktuar kodet-shifrat për produkte. Ndërsa sa i përket mungesës së nënshkrimit dhe vulës, eksperti shqyrtues sqaron se këtë gjë AK-ja ka mundur të verifikoj duke kërkuar sqarime konform nenit 72 të LPP-së.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

OE ankues thekson se sa i përket arsyes së tretë të eliminimit tonë nga ky aktiviteti i prokurimit, ku AK-ja ka cekur kinse "Plani i menaxhimit të trafikut nuk ka të bëjë me rastin specifik-qyteti i Rahovecit", ju sqarojmë se edhe ky arsyetim për eliminimin tonë është vetëm një pretekst për të na eliminuar neve si OE i përgjegjshëm dhe më i lirë në këtë aktivitet të prokurimit.
Ne në ofertë kemi prezantuar planin e menaxhimit të trafikut për aktivitetin e prokurimit "Sinjalizimi

Horizontal dhe Vertikal i Rrugëve" në KK Rahovec, mirëpo për ne është e çuditshme se si ka mundësi që AK-ja të na eliminoj kinse ky plan i prezantuar nga ne nuk ka të bëj me qytetin e Rahovecit, për deri sa ne kemi ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit i iniciuar nga vet KK Rahovec, ku edhe tek titulli i planit të menaxhimit të trafikut shkruan se Sinjalizimi do të bëhet në komunën e Rahovecit. Ky arsyetim i juaji edhe një herë po e dëshmon qartë diskriminimin që po na bëni ju si AK neve si OE i përgjegjshëm dhe më i liri në këtë aktivitet të prokurimit.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*Një plan për menaxhimin te trafikut*"

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Të prezantohet plani për menaxhim te trafikut i nënshkruar nga Inxhinieri ose Bachelor i Komunikacionit dhe përpilohet për rastin specifik-qyteti i Rahovecit*".

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se, operatori ekonomik ankues ka ofruar një plan të menaxhimit të trafikut i cili ka titullin e aktivitetit të prokurimit të KK-Rahovec, numrin e prokurimit si dhe tre skema të cilat janë të nënshkruara dhe vulosur.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

OE ankues pretendon se AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE i cili nuk përmbush të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm për faktin se i njëjti nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale në lidhje me stafin e kërkuar. Tek dosja e tenderit është kërkuar që OE ofertues ti posedojnë 8 punëtorë gjithsej duke përfshirë edhe stafin profesional, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë i ka prezantuar gjithsej 7 punëtorë në listën e stafit.

I njëjti tek lista e stafit është munduar të manipuloj me listën e stafit ku tek numrat e listës mungon numri katër, ku është i çuditshëm fakti se si AK-ja nuk e ka vërejtur me apo pa qëllim një fakt të tillë.

Tek kapaciteti teknik dhe profesional të dosjes së tenderit është kërkuar: **Kërkesa 1**"*Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, min. 6 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca (vite) dhe pozicioni në kompani*"

Kërkesa 2: "*2.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Makinerisë ose Master – Drejtimi Komunikacion Rrugor, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit*"; *"2.2. Udhëheqësi i Punishtes – Master ose Bachellor i Komunikacionit, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit"*.

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: **Dëshmia 1**"*Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, min. 6 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperienca (vite) dhe pozicioni në kompani dhe nënshkrimi i punëtorëve ne atë liste – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik*"

Dëshmia 2 "*Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar; CV-në (të nënshkruar nga vetë pala); Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt;Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;Një deklarate me shkrim për caktimin e Menaxherit te Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 2.1 & 2.2"*

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar dokumentacionin e ofruar në E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit thekson se, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë për plotësimin e kërkesës së DT-së lidhur me stafin, ka prezantuar një listë të stafit e nënshkruar prej shtatë (7) personave.

Tek përshkrimi i profesionit për këtë staf, tre prej tyre janë inxhinier të komunikacionit, një makinist për shenjëzime horizontale, një makonist/punëtor, si dhe dy punëtorë. Eksperti shqyrtues sqaron se në këtë aktivitet të prokurimit janë kërkuar gjashtë(6) punëtor të cilët janë staf teknik, si dhe dy prej tyre janë kërkuar staf profesional, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë i ka ofruar gjithsej shtatë (7) persona duke përfshirë në total edhe stafin profesional edhe punëtorët (stafin teknik). Andaj nga përshkrimi si më lartë rezulton se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar stafin sipas kërkesës së dosjes së tenderi. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 5

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk e plotëson edhe kërkesën e dosjes së tenderit përkatësisht tek kapaciteti teknik dhe ose profesional. OE i rekomanduar për kontratë lidhur me kërkesën e lartcekur ka ofruar znj. Fetije Kuçi-Krasniqi si inxhiniere të

komunikacionit përkatësisht menaxhere të projektit, e për të cilën ka bashkangjitur një referencë të lëshuar nga OE i rekomanduar për kontratë, ku shkruan se e njëjta ka kryer punë nga periudha Mars 2018 deri në Mars 2020. Në kontratën e lidhur në mes inxhinieres dhe OE të rekomanduar për kontratë figuron se e njëjta kontratë është e lidhur me dt.08.03.2018, ndërsa e punësuara do të ketë pozitën në kompani me titull: Inxhiniere e komunikacionit. Nëse analizohet diploma e inxhinieres, shihet qartë se e njëjta ka diplomuar me dt. 12.04.2018, datë kjo që tregon mos përputhje në mes datës së kontratës dhe datës së diplomimit, pasi që kontrata është lidhur për pozitën inxhiniere të komunikacionit ende pa i përfunduar studimet. Pra ne dyshojmë se kontrata është fiktive sepse nuk mund dhe nuk duhet të lidhet një kontratë për një pozitë me titull Inxhiniere, përderisa e njëjta nuk posedon titullin inxhiniere.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Makinerisë ose Master – Drejtimi Komunikacion Rrugor, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit*"

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar; CV-në (të nënshkruar nga vetë pala); Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt; Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit;*

Një deklarate me shkrim për caktimin e Menaxherit te Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 2.1 & 2.2"

Për plotësimin e kësaj kërkese të DT-së, operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka prezantuar znj. Fetije Kuçi Krasniqi si inxhiniere të komunikacionit, për të cilën është ofruar dëshmi si Diploma e noterizuar, kontratë pune me kohë të caktuar, CV-ja si dhe një referencë e lëshuar nga OE i rekomanduar për kontratë. Mirëpo në diplomën e inxhinieres data e diplomimit është cekur 18 Prill 2018, në kontratën e punës në kohë të caktuar ceket se inxhinierja punën duhet ta filloj me dt.08.03.2018 dhe dt.09.03.2018 me titull si inxhiniere e komunikacionit. Nga përshkrimi i dhënë kuptohet që janë dhënë dy data të fillimit të punës si dhe ka mos përputhje të datave për faktin se e njëjta në kohën e nënshkrimit të kontratës nuk ka qenë e pajisur me diplomë që të mbaj titullin inxhiniere. Andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 6

OE ankues thotë se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku kërkesë ka qenë "Katalogu i produkteve të kompanisë me kod dhe shifër për secilin produkt". OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë për faktin se i njëjti ka prezantuar kode në katalog të cilat nuk janë në përputhje me udhëzimin administrativ MI Nr.09/2017 për Sinjalizim dhe Rregullat e trafikut Rrugor. Në udhëzimin e lartcekur ashtu siç e kemi cekur edhe më lartë janë të përcaktuar qartë kodet dhe shifrat për produktet e sinjalizimit dhe asnjë OE nuk mund dhe nuk duhet të vendos kode tjera, pasi që në këtë rast AK-ja nuk e ka respektuar pasi që ka rekomanduar për kontratë një OE i cili ka prezantuar në ofertën e tij kode të cilat nuk janë në përputhje me udhëzimin e lartcekur.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*Katalogu i produkteve të kompanisë me kod dhe shifër për secilin produkt*".
Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Një kopje e katalogut i nënshkruar dhe vulosur nga personi i autorizuar i Kompanisë*".

OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka prezantuar katalogun me produktet, i cili është i nënshkruar dhe vulosur, gjithashtu në fund të çdo produkti është i vendosur nga një shifër (kod) për secilin produkt ashtu siç është kërkuar në DT, mirëpo ekziston edhe një Udhëzim Administrativ i Ministrisë së Infrastrukturës me nr.09/2017 i cili është burim thelbësor për natyrën e aktivitetit të prokurimit dhe në këtë udhëzim janë tjera shifra që nuk përputhen me shifrat të cilat i ka dhënë OE i rekomanduar për kontratë në katalogun e tij, ndaj dhe eksperti shqyrtues konsideron pretendimin e OE ankues si pjesërisht të bazuar për faktin se shifrat janë ofruar sipas kërkesës së DT-së, mirëpo nuk është marrë parasysh Udhëzimi Administrativ si akt nënligjor i cili rregullon drejtpërdrejt fushën e sinjalizimit.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "Lindi Markings" Sh.p.k & "BENI-COM" Sh.p.k Vitomiricë, të aprovohet si pjesërisht e bazuar, dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - KK - Rahovec

Panelit Shqyrtues - OSHP

OE ankues -OE "Lindi Markings" Sh.p.k & "BENI-COM" Sh.p.k Vitomiricë